



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 37 (2, 3, 4) dhe Rregullores (QRK) Nr. 03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, Neni 8, Komuna e Prishtinës, shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Grupi ligjor
Titulli i pozitës së punës	Udheheqës I Sektorit për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta - Projekt
Arsyeja për rekrutim kontraktual	Për realizimin e një projekti
Koeficienti/Paga	7.3
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Tre (3) vite
Data e njoftimit	08/05/2024
Afati për aplikim	09/05/2024 - 17/05/2024
Institucioni	Komuna Prishtinë
Departamenti	Kabineti i Kryetarit
Divizioni	
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00013982
Kodi	RPC0007521



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Udhëheqë Sektorin për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e UÇK-së;
- I Raporton kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Përfaqëson dhe promovon të drejtat e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së siç janë: invalidët, veteranët dhe familjet e dëshmorëve të UÇK-së;
- Trajton kërkesat dhe nevojat për kategorit e dala nga lufta në territorin e Komunës së Prishtinës;
- Koordinon aktivitetet e komunës së Prishtinës me rastin e organizimit të datave të rëndësishme që ndërlidhen me luftën e UÇK-së;
- Propozon kërkesën për ndarjen e buxhetit për funksionalizimin e zyrës;
- Propozon kërkesën për ndarjen e buxhetit për realizimin e projekteve të ndryshme;
- Organizon, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e sektorit.
- Organizon, mbikëqyr dhe motivon punën e personelit dhe jep udhëzime dhe urdhëresa për punë;
- Preferohet që kandidatet të jenë nga kategorit e dala nga lufta e UÇK-së nepermjet dëshmisë se vërtetimit apo certifikatës se i takon kësaj kategorie;

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë Universitarë (Bachelor).
- Kërkesat specifike: Diplomë Universitare, drejtimi Juridik.
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 3 (tre) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



## 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Njohuri dhe përvojë pune në perfaqsim dhe realizim të të drejtave të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së;
- Shkathtësi në menaxhim, organizim, caktimit të objektivave dhe planifikim;
- Shkathtësi në komunikim;
- Përvojë në organizime të aktiviteteve që ndërlidhen me datat e rëndësishme të UÇK-së;
- Shkathtësi të organizimit dhe mbikëqyrjes së punës;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power- Point, e te tjera);

## 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

### Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit.

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 01/06/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 7. Kriteret specifike shtesë

---

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë, janë si në vijim:

- Ligji nr. 08/L-197 për zyrtar publik
- Ligji për kategorite te dala nga lufta e UÇK-së
- Ligjet tjera zbatuese nga Komuna e Prishtinës.

### \*\*\*VËMENDJE:

"Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP".

"Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë, nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen".

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim – maksimumi 0 pikë
- Intervista – maksimumi 100 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.



**Të dhëna shtesë:**

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësi përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve ne origjinal apo të njësuar me origjinalin.

**Linku se si të aplikoni përmes platformës SIMBNJ:**

**<https://www.youtube.com/watch?v=olwDDqCUeZI>**

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

